

VENDIM

Nr. 528, datë 10.11.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 75, DATË 23.5.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, “PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE PËR REKRUTIMIN E KANDIDATËVE PËR GJYQTARË, PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS SË GJYQTARËVE DHE PËR EMËRIMIN E GJYQTARËVE TË GJYKATËS SË LARTË”

Në mbështetje të nenit 147, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 61, pika 2, gjerat “P” dhe “j”, nenit 70, pika 2, neneve 85 dhe 86, gjerat “a”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i ndryshuar, neneve 32, 35, 36, 48, 49 dhe 55, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 75, datë 23.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në bazën ligjore të vendimit, pas fjalëve “të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” shtohen fjalët: “nenit 61, pika 2, gjerat “j” dhe “j”, nenit 70, pika 2”.

2. Në fjalinë e parë të pikës 7, kreu IV, hiqet togfjalëshi “janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës”.

3. Seksioni A, kreu X, shfuqizohet.

4. Seksioni B, kreu X, ndryshohet si më poshtë:

“B. Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt rivlerësimi kalimtar

1. Kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për periudhën e rivlerësimit kalimtar, vendimi i Këshillit mbështetet në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit.

2. Për kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, për të cilët nuk ka filluar ose nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon shqyrtimin me përparësi të këtij procesi ndaj tyre. Për këta kandidatë fillon verifikimi i pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procedura e verifikimit përmbyllet mbas dhe në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar.

3. Marrja e masës disiplinore, sipas neneve 60 dhe 61, të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përbën shkak për skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e ngritjes në detyrë të kandidatëve subjekt rivlerësimi kalimtar”.

5. Pika 1, seksioni Ç, kreu X, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Qoku